2. Programi i studimeve – Studime të Doktoratës Shëndet Publik

2.1.Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit	**Shëndet Publik**
KKK Niveli (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktorate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	**PhD**
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	**Doktor i Shkencave mjekësore, Programi shëndet publik - PhD**
Grada akademike sipas *Erasmus Subject Area Codes (ESAC)*	**Doktor i i Shkencave mjekësore, në Shkencat e shëndetit publik - PhD - 12.0**
Profili i programit akademik	**Drejtimet e Mjekësisë**
Grupi qëju dedikohet programi	**Studentëve të diplomuar të Mjekësisë (Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci);**
Kohëzgjatja minimale e studimit	**3 vite (6 semestra)**
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	**E rregullt**
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	**180/60 ECT**
Modulet /Lendet (titujt)	Biostatistika me informatikë mjekësore Metodologjia e hulumtimeve shkencore Etika në hulumtimet mjekësore Vlerësimi i riskut mjedisor Principet dhe metodat e Epidemiologjisë Principet e kujdesit shëndetësor dhe dhe menaxhmenti Kariesologjia Epidemiologjia dhe kontrolli i sëmundjeve ngjitëse Epidemiologjia dhe kontrolli i sëmundjeve jongjitëse Principet dhe praktikat e diagnostikimit të sëmundjeve ngjitëse Paraqitja dhe riparaqitja e infeksioneve Mbikqyrja dhe raportimi i sëmundjevekronike dheinfektive Epidemiologjia e semundjeve orale Menaxhimi i situatave emergjente Kontrolli i infeksionit Legjislacioni ndërkombëtar mjedisor Siguria e ushqimit Nutricioni dhe shëndeti publik

	Politika e shendetit oral dhe mplakja Strategjitë shëndetësore dhe sistemet shëndetësore Politikat publike dhe administrimi i sherbimit te shendetit oral Edukimi shëndetësor dhe shkencat e sjelljes Sëmundjet profesionale&parandalimi i lëndimeve Hulumtimi ne komunitet i shendetit publik stomatologjik Promovimi i shendetit oral dhe stomatologjia preventive **Teza e PhD**
Numri i vendeve të studimit	**10**
Udhëheqës i drejtimit të studimit	**Prof. Dr. Tahire Maloku-Gjergji**
Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	**Prof. Dr. – 4** **Prof. Assoc – 7** **Prof. Ass. –6** **Dr.sc. ass- 3** **Asistentë - 10**
Taksat e studimit	**1000 €/Semester**

2.2. Arsyeshmëria e programit për tregun e punës me orientim profesional

Shkenca dhe praktika e shëndetit publik luan rol kyç në promovimin e shëndetit të popullatësdhe reformës së sistemit shëndetësor, sidomos sa i përket monitorimit të statusit shëndetësor dhe hulumtimit të determinantave të tij, vendosjes së një sistemi të drejtë dhe efikas për financimin e kujdesit shëndetësor, si dhe qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore. Zhvillimi i shëndetit publik kërkon hulumtime që do të kenë qasje multidisiplinare dhe aplikim të zgjidhjeve të reja të kujdesit shëndetësor të bazuar në evidencë, të cekur qartë në Strategjinë sektoriale të shëndetësisë së Kosovës 2014-2020.

Sipas Programit Kombëtar të shkencës në Kosovë, një prej grupeve prioritare në fushën e hulumtimit shkencor në mjekësi vazhdon të mbetet zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në shëndetin publik, me theks te veçantë në këto drejtime si parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive, shëndeti mendor, shëndeti i nënës dhe i fëmijës dhe varshmëria nga substancat e ndryshme.

Fusha e shëndetit publik është e rregulluar nga një numër i madh ligjesh e aktesh nënligjore. Në Kosovë, ekziston edhe një ligj i veçantë për shëndetësinë publike.

Sfidat e shëndetësisë publike, me të cilat ballafaqohet Republika e Kosovës, mund të shqyrtohen nëpërmjet analizës së:

- Situatës epidemiologjike të çrregullimeve shëndetësore,
- Statusit shëndetësor të grupeve të ndryshme të popullatës,
- Ambientit të jetesës dhe të punës,
- Aspekteve organizative dhe strukturore të shëndetësisë publike.

Zhvillimi i institucioneve për edukim dhe hulumtim në shëndetesi publike është në trend të zhvillimit global me theks të veçantë kah programet edukative të specializuara në fusha të ndryshme, vazhdimi i ofrimit tëprogrameve ekzistuese dhe të reja, zhvillimi i “fushave ndërdisiplinare”, rritja e rëndësisë së edukimit të vazhdueshëm profesional dhe edukimit nga distanca.

Ofrimi i formave të ndryshme të avancimit dhe edukimit, me qasje multisektoriale, në Shkollën e Shëndetit Publik në Kosovë, që vepron përmes Katedrave të lëmive të shëndetësisë publike, mundëson trajnim të qëndrueshëm nga fusha e shëndetit publik në shumë segmente me qasje multisektoriale dhe dimension ndërkombëtar.

Përkundër kapaciteteve lokale të kufizuara, Kosova ka mundësi të ndërtoj dhe funksionalizoj ekipe të punës në hulumtime në fushën e shëndetësisë publike. Kështu, ky projekt do të ndihmoj përgatitjen e ekspertëve me kualifikim të lartë si një bërthamë e mirë për të fuqizuar kapacitetet hulumtuese, si dhe të realizohet ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti gjatë ciklit studimor të PhD, duke adresuar nevojat për krijimin e ekspertëve nga fusha shkencore e Shëndetit Publik.

Si i tillë, programi i zbatuar me gjeneratën e parë, i vlerësuar në mënyrë kritike, gjatë mësimdhënies, mësimnxënies dhe konsultimeve me mësimdhënës vendor dhe ndërkombëtarë si dhe studentë të studimeve të doktoratës, ka ndihmuar që ky program sot të pasurohet duke ju mundësuar kandidatëve që të thellohen në punën e tyre hulumtuese-shkencore, por që njëkohësisht nga kjo punë të përfitojnë shkathtësi profesionale dhe kualifikime përkatëse për profesionet e tyre të ardhshme për të mirën e shoqërisë në përgjithësi.

2.3. Krahasueshmëria ndërkombëtare e programit

Ky program studimor është i përcaktuar për të dhënë kontribut në realizimin e qëllimeve të UP-së, duke i mundësuar Republikës së Kosovës të afrohet fushave evropiane të hulumtimeve dhe fushave evropiane të shkollimit të lartë.

Programi i doktoratës 'Shëndeti Publik'' përfshin në vete disa nga principet bazike të cilat e karakterizojnë: qasja ndërdisiplinorenën paradigmën "shëndetësi publike e re", dhe bashkëpunimi i ndërsjellët në mes të ekspertëve të programit si bazë plotësuese për zhvillimin e fushave të caktuara shkencore-hulumtuese nga shëndeti publik (Biostatistika,Epidemiologjia e sëmundjeve kronike, Ekologjia shëndetësore, Epidemiologjia e sëmundjeve ngjitëse, Menaxhimi I politikave shëndetësore).

Ky program ka për qëllim të vazhdoj bashkëpunimin akademik me partnerët ndërkombëtar dhe me institucione të shëndetit publik në mbarë vendin. Në nivelin e Republikës së Kosovës, programi I studimeve të doktoratës do të mundësojë vazhdimin e bashkëpunimit si dhe konsultimet e afërta dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve, partnerëve publik dhe privat, duke siguruar kështu konsistencë dhe kualitet në bashkëpunimin e të gjithë partnerëve të programit. Për më shumë, çështjet si janë kualiteti, ndërkombëtarizimi, mobiliteti, promovimi i punës shkencore, zhvillimi dhe ndërtimi i një shoqërie me dije dhe njohuri janë në fokus të këtij programi.

Në nivel ndërkombëtar, bashkëpunimi me organizata dhe shoqata ndërkombëtare (WB, WHO, UNAIDS, UNICEF, ASPHER, EUPHA, FPH-SEE etj.), me rrjetin rajonal të shkollave të shëndetit publik, i cili është krijuar në kuadrën e Paktit për Stabilitet në Evropën Jug-Lindore, si edhe shoqata e shkollave të shëndetit publik në rajonin Evropian dhe anëtarët e saj (Shkolla e Shëndetit në Bielefeld-Gjermani; Mastricht-Holandë, Bordeaux-France, Shkolla e Londrës për Higjenë dhe Mjekësi Tropike; Shkolla e Shëndetit Publik "Andrija Shtampar" në Zagreb, Shkup, Tiranë, etj.), Dartmouth Medical School ne SHBA, University Illinois of Chicago, SHBA, kanë shërbyer si modele inspiruese për hartimin dhe përditësimin e këtij programi të doktoratës.

Kriteret për ECTS, strukturën e moduleve, përmbajtjen e tyre, raportin në mes pjesës praktike dhe asaj teorike dhe detyrave të vetëmësimit të studentëve janë adaptuar sipas kërkesave dhe kushteve të Kosovës.

Fushat kryesore të bashkëpunimit janë edukimi, përgatitja e tezave, aktivitete shkencore dhe studimore, shërbime konsultative, programe dhe aktivitete në promovimin shëndetësor, shkolla verore. Në këtë drejtim disa nga projektet që vlenë të përmenden janë të prezantuara në fund të dokumentit, shtojca nr.1.

https://www.meduniwien.ac.at/homepage/content/studium-lehre/studienangebot/n790/

https://www.meduniwien.ac.at/homepage/content/studium-lehre/studienangebot/n790/thematic-programs/

2.4. Grupi target që i dedikohet programi

Ky program i studimit i dedikohet grupit target: studentëve të diplomuar të Fakultetit të Mjekësisë që kanë arritur së paku 300 ECTS gjatë studimeve.

Sipas ETCS sistemit një vit shkollor vlerësohet me 60 kredi.

Numri i përgjithshëm i kredive për përfundimin e obligimeve mësimore = 180 ECTS.

2.5. Orientimi i programit të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit

Kurrikulumi i Shëndetësisë Publike ofron mundësinë që studentët e programit të Doktoratës të zgjedhin një fushë të hulumtimit, ku hyjnë epidemiologjia, ekologjia humane, mikrobiologjia, mjekësia sociale, politikat publike dhe administrimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor. Ky program ka për qëllim që të aftësojë profesionistët e përkushtuar me njohuri të zgjeruara për problemet shëndetësore nga aspekti i shëndetësisë publike.

Për kompletimin e programit çdo student duhet të kryejë modulet kryesore dhe ato zgjedhore.Në kuadër këtij programi doktoral të studimit është dhënë lista e moduleve/lëndëve zgjedhore,të cilat në vete përmbajnë edhe emërtimin e modulit/lëndës dhe bartësit të tij, emri i ligjëruesit dhe bashk-ligjëruesve, numri i orëve, forma e kursit, përshkrimi i medotave të parapara për zhvillimin e mësimit, literatura e nevojshme për të studiuar, përshkrimi se si do të kryhet vlerësimi dhe monitorimi gjatë studimeve të doktoratës, si dhe e projekteve shkencore në të cilat institucioni propozon të zhvillohen studimet e doktoratës të cilat janë zhvilluar në pesë vitet e kaluara dhe që kanë qenë relevante për fushat hulumtuese.

Pas përfundimit të moduleve kryesore, studentët do të vendosin për një fushë të studimit të cekur më lartë. Gjatë punës me udhëheqësit e tyre shkencorë, studentët do të zgjedhin modulet e duhura me qëllim të ndërtimit të ekspertizës në fushën e caktuar duke zgjedhur tezën apo fushëveprimin e duhur sipas zgjedhjes së tyre.

Shëndeti publik përfshin disiplinat që shfrytëzojnë punën në departamente, laboratore, hulumtimet në terren, shkencat sociale, fushën e politikave publike dhe analizën statistikore.Thelbi i këtij programi qëndron në zotërimin e metodave kërkimore në disiplinat speciale të zgjedhur nga kandidati.

Studimet e doktoratës zgjasin tre vjet (gjashtë semestra).Ato organizohen sipas planit dhe programit mësimor.Mësimi zhvillohet në mënyrë të organizuar bazuar në planin dhe programin e studimeve.

Studimet janë të harmonizuara me sistemin e transferit Europian të pikëve (European Credit Transfer System – ECTS), për të mundësuar lëvizshmërinë e studentëve ndrëmjet fakulteteve të shteteve të tjera Evropiane.

Mësimi organizohet në Module që kanë vlerën e përcaktuar të kredive, në formë të ligjeratave, të seminareve dhe të ushtrimeve.

Studentët janë të obliguar të participojnë në të gjitha format mësimore (më së paku në 80% të procesit mësimor), për çka mbahet evidencë e posaçme.

Propozimi i këtij programi ka për qëllim zhvillimin dhe zbatimin e programit të PhD nga Shëndeti Publik, dhe për më shumë edhe modernizimin e strukturës dhe procesit të përgjithshëm të studimeve të doktoratës/PhD në UP. Fushat operative në të cilat ky program i PhD-së do të vepron, është në përputhshmëri perfekte me prioritetet e vëna gjatë zhvillimit të Fakultetit të Mjekësisë, atyre të MASHT-it.

Principet që e karakterizojnë këtë program janë: solidariteti akademik i bazuar në bashkëpunim dhe kooperim, qëndrueshmëria dhe pronësia lokale, ndërtimi i kapaciteteve institucionale si dhe kualiteti dhe vlefshmëria e gjithë projektit.

2.6. Qëllimi dhe profili i programit të studimeve (përshkrimi i programit)

Qëllimi i programit të Studimeve të Doktoratës në fushën e Shëndetësisë Publike është që të ofroj mundësinë e kërkimeve shkencore për grupe të caktuara të hulumtuesve të zgjedhur.

Programi i PhD "Shëndet Publik" "synon të përgatis studentët me shkathtësitë relevante për qasje në konceptet e ndryshme varësisht nga disciplinat dhe shfrytëzimin e metodologjisë përkatëse për zgjidhjen e problemeve nga fusha e Shëndetësisë Publike.

Kandidatët duhet të dëshmojnë me aktivitetet e tyre se zotërojnë metodat hulumtuese për të ndërmarrë hulumtime të pavarura dhe se arritja e gradës shkencore të doktoratës nuk kufizohet vetëm në kompletimin me sukses të hulumtimit.

2.7. Rezultatet e pritura të mësimit (kompetencat dhe kualifikimet, njohuritë dhe shkathësitë)

Kandidatët e doktoratës të cilët planifikojnë të ndjekin dhe përfundojnë këtë program PhD studimi, duhet të zhvillojnë kompetencë për punë të pavarur shkencore sikur edhe të trajnohen dhe të përkrahin punën shkencore në përputhje të plotë me principet dhe standardet e njohura ndërkombëtare për praktikën e mirë shkencore dhe etikën në shkencë dhe hulumtim.

Pas përfundimit të studimeve të doktoratës, kandidatët duhet të aftësohen që:

- Të realizojnë punë të pavarur shkencore në fushat e Shëndetit publik
- Të kenë aftësi për të planifikuar, zbatuar dhe adaptuar projektet shkencore me komponentë hulumtuese
- Të udhëheqin analiza kritike të literaturës shkencore nga fusha e shëndetësisë publike dhe aplikojnë dizajne të përshtatshme për hulumtim, grumbullim dhe interpretim të të dhënave, identifikim të faktorëve të rrezikut dhe intervenimeve shëndetësore drejtuar individit dhe popullatës
- Të kenë aftësi për aplikuar hulumtimet shkencore përmes simbiozës së punës praktike dhe asaj hulumtuese, analizat e vendimeve klinike për diagnostikimin, mjekimin, parandalimin dhe prognozën e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore dhe aftësohet për udhëheqje të politikave shëndetësore dhe menaxhment shëndetësor
- Të aftësohen në qasjen e bazuar në kërkime shkencore për monitorimin e shëndetit dhe determinantave të shëndetit, promovimin, parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore
- Të aplikojnë analizat e vendimeve klinike për diagnostikimin, mjekimin, parandalimin dhe prognozën e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore;
- Të hulumtojnë në lëminë e epidemiologjisë mjedisore, toksikologjisë, vlerësimin e riskut, ekspozimit, biomarkerët
- Të kenë aftësi për të komunikuar në mënyrë profesionale me komunitetin shkencor dhe shoqëror në përgjithësi për të sqaruar pyetjet bazike shkencore
- Të gjenerojnë rezultate origjinale shkencore duke i publikuar ato në revista të njohura shkencore.

Me përfundimin e studimeve të doktoratës dhe me mbrojtjen e punimit të doktoratës, kandidati fiton titullin e doktorit të shkencave mjekësore (shkurtesa Dr.sc.).

2.8. Raporti në mes të pjesës teorike dhe pjesës praktike të programit të studimit

Semestri	**L**	**S**	**U**	**VM**	**Total orë**	**ECTS**
Semestri I –rë	75	90	110	485	750	30 ECTS
Semestri II-të	-	80	90	580	750	30 ECTS
Semestri III-të	-	30	30	690	750	30 ECTS
Semestri IV-të	-	30	30	690	750	30 ECTS
Semestri V-të	-	30	30	690	750	30 ECTS
Semestri V-të	-	30	30	690	750	30 ECTS
Total					**4500**	**180 ECTS**

L- ligjërata

S- seminar

U- ushtrime

VM- vetmësim

2.9. Llogaritja e ECTS-ve

Kreditë të cilat shprehin kualitetin e punës të secilës njësi të kursit, në raport me punën e përgjithshme, dhe të cilat janë të nevojshme për të plotësuar një vit studimi shprehen me sistemin e ECTS-ve të cilat shfrytëzohen për tu grumbulluar kreditë e studimit në bazë të transparencës dhe krahasueshmërisë kualitative.

Në kuadër të sistemit të ECTS-ve, kualiteti i punës brenda një viti të studimit duhet të korrespondoj me 60 ECTS kredi, derisa një semestër i studimit korrespondon me 30 ECTS kredi.

2.10. Puna praktike dhe rotacion në departamentet dhe njësitë laboratorike

Për të përmbushur objektivat e punës praktike dhe rotacionit të këtij programi të PhD, krahas mësimit, hulumtimit dhe zbulimit të risive, studentët do të shfrytëzojnë punën e departamenteve dhe laboratoreve të IKSHPK-së, hulumtimet në terren, shkencat sociale, politikat publike dhe analizat statistikore.

Gjatë semestrit të 1^{rë} dhe të 2^{të}, është planifikuar që secili student i doktorates të kaloj më s'paku gjashtë javë në rotacion në katër departamentet dhe tri njësitë laboratorike të IKSHPK dhe të Fakultetit të Mjekësisë.Ky rotacion duhet të përfundoj me shkrimin e një raporti dhe përshkrimin e ideve konkrete hulumtuese për shfrytëzimin e departamentit/laboratorit përkatës.

Qëllimi i këtij rotacioni është që tu mundësoj studentëve që të mësojnë në lidhje me hulumtimet e tyre të planifikuara, të zotërojnë teknika dhe shkathtësi të punës hulumtuese-shkencore dhe të krijojnë bazën dhe idenë për zgjedhjen e profesorit kryesor I cili mund edhe të jetë mentor për tezën e doktorantit në të ardhmen.Konsiderohet e domosdoshme që pas mbarimit të rotacionit të bëhet një përshkrimi i përgjithësuar dhe të pregaditet si prezentim oral për një kohë 10-15 minuta. Studenti i cili nuk ka plotësuar dhe nuk ka prezentuar sukseshëm rotacionin nuk do të marrë notë kaluese nga kjo fazë e trajnimit.

2.11. Plani i hulumtimeve

Kandidatët e doktoratës duhet të krijojnë tezën e tyre të projektit në kuadër të kurseve të këtij programi dhe duhet të jenë pjesëmarrës në kurset e kërkuara në përputhje me Rregulloren për Studime të Doktoratës të UP-së (Nr.2/282, dt.03.10.2013).

Programi i PhD përbëhet nga një program studimi i cili zgjatë 6 semestra (180 ECTS). Në kuadër të semestrit të parë dhe të dytë studentët mund të grumbullojnë 60 ECTS (30+30 ECTS).

Gjatë procesit studimit, Institucioni shkollor do të siguroj që modulet të cilat do ti ndjekin studentët t'ju mundësoj atyre të kuptojnë metodat shkencore dhe të aplikojnë ato në hulumtimet shkencore dhe praktikën profesionale në në fushat e shëndetit publik.

Në semestrin e tretë, secili student do të përgatit dhe mbroj projekt propozimin e tezës së studimeve të doktoratës/PhD.

Në semestrin e katërt studentët do të kryejnë hulumtime shkencore nga fushat e përzgjedhura në përputhje me projekt propozimin dhe tezën e tyre të doktoratës/PhD e cila është aprovuar nga Këshilli i Doktotatave i Fakulteti të Mjekësisë dhe nga Këshilli Qendror i studimeve të doktoratës në nivel të UP-së. Rezultatet e gjeneruara nga puna hulumtuese duhet të publikohen në ndonjë revistë shkencore me impakt faktor (IF) me recension ndërkombëtar apo në ndonjë konferencë ose takim tjetër shkencor me relevancë ndërkombëtare.

Në semestrin e pestë dhe të gjashtë studentët do të përgatiten dhe mbrojnë publikisht temën e tyre të doktoratës/PhD.

Semesteri	Përshkrimi
Parë (I-rë)	Studenti grumbullon 30 ECTS kredi nga modulet dhe lëndët e përzgjedhura, nga rotacioni nëdepartamente, seminar I tezës së doktoratës dhe jurnal klub
Dytë (II-të)	Studenti grumbullon 30 ECTS kredi nga modulet e përzgjedhura në formë të seminareve dhe fusha e tyre e interesit dhe e aplikimit
Tretë (III-të)	Studenti grumbullon 30 ECTS kredi pas miratimit dhe aprovimit të projekt propozimit të tezës së doktoratës dhe pas nominimi të mentorit nga senati i UP-së
Katërt (IV-të)	Studenti grumbullon 30 ECTS kredi pas publikimit të një pjese të rezultateve të fituara në ndonjë revistë shkencore me recension ndërkombëtar të fushës gjegjëse dhe me impakt faktor (IF)
Pestë (V-të)	Studenti grumbullon 60 ECTS kredi pas mbrojtës me sukses të tezës së doktoratës
Gjashtë (VI-të)	

2.12. Kushtet e regjistrimit dhe pranimit të studentëve

Kushtet e përgjithshme dhe të nevojshme për tu regjistruar në këtë program të doktoratës/PhD janë:

- Diploma e studimeve të kryera nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Stomatologjisë
- Diploma e studimeve të kryera nga Fakulteti i Farmacisë (min. 300 ECTS)
- Diplomë e nivelit kombëtar apo ndërkombëtar nga studimet e magjistraturës e cila është e barazvlefshme me diplomat e lartpërmendura të studimeve. Rektorati do të vendos për barasvlerën e kurseve dhe procedurat tjera të pranimi.
- Kandidatët duhet të flasin dhe shkruajnë rrjedhshëm në Gjuhën Angleze
- Kandidatët të cilët gjatë studimeve të tyre të mëparshme ka arritur të kenë notë të lartë mesatare (mbi 8.00), do të kenë përparësi në përzgjedhje
- Nëse dy kandidatë konkurrues paraqiten me kushte të njëjta, dhe kur pranohet numër i kufizuar i kandidatëve, përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore

2.13 Strategjia e zbatimit të programit të studimit PhD"shendet publik" në universitetin e Prishtinës

2.13.1 Strategjia për stafin

Cilësia e mësimdhënësve në Fakultetin e Mjekësisë është e një rëndësie të jashtëzakonshme, sepse siguron përparimin e studimeve. Për këtë arsye Fakulteti i Mjekësisë ka orientuar politikat e saj për zhvillimin dhe promovimin në dy drejtime:

1. Avancimi në fushat akademike
2. Zhvillimi profesional dhe shkencor

Personeli mësimor nga fusha e shkencave natyrore, mjekësore dhe humane në vend është i mjaftueshëm dhe përmbush nevojat e këtij programi.
Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe hulumtimet në arsim, mjete të reja metodike do të mbështesin programin. Kjo gjithashtu përfshin edhe përmbajtje multimediale, si dhe krijimin e ambienteve arsimore bashkëpunuese me mjete të reja metodike. Mësimi bëhet në nivele të ndryshme të metodave didaktike, të tilla si të mësuarit PBL, mësim i orientuar kah subjekti, qasje didaktike ndërmjetës, megjithatë kjo duhet të udhëhiqet nga profesorët në Kosovë që kanë nevojë për trajnim. Në këtë drejtim Shkolla e shëndetit Publik e Zagrebit, me eksperiencë afatgjate do të kontribuojë në mënyrë aktive në ngritjen e kapaciteteve dhe shkathtësive të mësimdhënies e mësimnxënies dhe menaxhimit.

2.13.2 Mekanizmat për zbatimin e masave të sigurimit të cilësisë

Zbatimi i programit PhD në "Shëndet Publik"mundëson në të njëjtën kohë një pamje të efektit të rezultateve të grupit ndërdisiplinor të punës për zhvillimin e strukturës, se si specifikat e tyre reflektojnë në përmbajtjen e programit dhe në mënyrë eksplicite në zhvillimin e njohurive të kandidatëve të PhD-së. Ky vlerësim do të tregojë, nëse miratimi i programit ishte i suksesshëm.
Vlerësimi i programit është pjesë thelbësore e shkollës që përpiqet të arrijë standarde dhe konkurencë ndërkombëtare. Prandaj, të gjitha elementet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm do të inkuadrohen në procesin e punës së shkollës. Procesi i vlerësimit do të përmbajë elementet në vijim: struktura (ndërtesa dhe pajisjet), burimet njerëzore (numri, background-i arsimor me përqendrim në multi- profesionalizëm dhe aftësi), dhe përmbajtja e programit.
Është i planifikuar edhe vlerësimi nga kandidatët dhe mësimdhënësit.Performanca akademike përcillet dhe deponohet në dosje të kandidatit në baza vjetore.
Të gjitha procedurat lidhur me përgatitjen dhe shqyrtimin e projekt propozimit, mbrojtjen publike të projekt propozimit dhe Disertacionit të Doktoratës bazohen në Rregulloret dhe Ligjet në fuqi.

2.13.3 Numri i vendeve për studim

Numri i vendeve për studim është përcaktuar varësisht nga kriteret e Rregullores për studimet e doktoratës të UP, e që lidhet ngushtë me numrin e profesorëve të rregullt dhe të asocuar, si dhe numrin e profesorëve asistentë të cilët i plotësojnë kriteret sipas rregullores në fuqi.
Komisioni i nominuar nga Dekani i FM, në bashkëpunim me Keshillin qendror të studimeve të doktoratës, bënë selektimin dhe pranimin e kandidatëve duke u bazuar në konkurs dhe Rregulloren e studimeve të doktoratës të UP.

2.13.4 Financimi

Studenti është i obliguar që të përmbush të gjitha obligimet financiare, të përcaktuara me planin financiar të UP.
Studenti, i cili për shkaqe të caktuara, i ka ndërprerë studimet, me vazhdimin e tyre paguan shumat e përcaktuara sipas planit më tëri financiar të UP.

2.13.5 Ndërtesa dhe pajisjet

Infrastruktura fizike e shkollës (në godinën e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike) është relativisht modeste, por ajo përfaqëson një vend qendror për punë për ligjëruesit, studiuesit, studentët dhe punëtorët e tjerë të saj. Në ditën e sotme përparimet teknologjike në teknologjitë informative dhe në komunikim kanë ndikim të rëndësishëm në metodat e punës dhe mësimit.
Do të jenë në dispozicion hapësirat mësimore në IKSHPK dhe Fakultetin e Mjekësisë, UP. Në vazhdimësi nevojitet pajisja e shkollës me pajisje, kompjuterë, materiale mësimi, libra, zhurnale, etj.

2.14. Kurikulumi i Studimit

Pasqyra e Programit PhD: Drejtimi Shëndeti Publik

	Viti I-rë						
Semestri I			Orët/semester				
Nr.	O/Z	Lëndët seminarike	L	S	U	ECTS	Mësimëdhënësi
1	O	Biostatistika me informatikë mjekësore	15	15	15	5	Prof. Asoc. Merita Berisha Prof. Ass. Ilir Begolli
2	O	Metodologjia e punës kërkimoro-shkencore	15	15	15	5	Prof. Asoc. Merita Berisha Prof. Ass. Ilir Begolli Prof. Dr. Isuf Dedushaj
3	O	Etika në hulumtimet mjekesore	15	15	15	5	Prof. Asoc. Naser Ramadani Prof. Ass. Sefedin Muçaj

4	O	Journal club	0	15	15	3	Prof. Dr. Isuf Dedushaj Prof. Dr. Selvete Krasniqi Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Merita Berisha Prof. Assoc. Naser Ramadani Prof.Assoc. Isme Humolli Prof.Ass. Ilir Begolli Prof.Ass. Lul Raka Prof.Ass. Sefedin Muçaj
5	O	Seminar i tezës së doktorates - I	0	15	15	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji Mentorët e kandidatëve
6	O	Rotacioni nëpër departamente	0	5	25	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli
7		Lëndë Zgjedhore I				3	
8		Lëndë Zgjedhore II				3	
		Total				30 ECTS	

Studenti përzgjedhë 2 lëndë zgjedhore.

	Viti I-rë						
Semestri II				Orët/semester			
Nr.	O/Z	Lëndët seminarike	L	S	U	ECTS	Mësimëdhënësi
1	O	Journal club	0	15	15	3	Prof. Dr. Isuf Dedushaj Prof. Dr. Selvete Krasniqi Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Merita Berisha Prof. Assoc. Naser Ramadani Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli Prof. Ass. Lul Raka Prof. Ass. Sefedin Muçaj
2	O	Seminar i tezës së doktorates - II	0	15	15	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji With mentor
3	O	Rotacioni nëpër laboratoret eksperimentale		10	20	2	Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Ass. Burim Neziri Prof. Ass. Shaip Krasniqi Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli

		Lëndë Zgjedhore I				4	
		Lëndë Zgjedhore II				4	
		Lëndë Zgjedhore III				4	
15		Aprovimi i temës së doktoratës				10	Mentori i kandidatit
		Total				30 ECTS	

Studenti përzgjedhë 3 lëndë zgjedhore.

	Viti II-të						
Semestri III-të				Orët/semester			
Nr.	O/Z	Lëndët seminarike	L	S	U	ECTS	Mësimëdhënësi
1	O	Journal club	0	15	15	3	Prof. Dr. Isuf Dedushaj Prof. Dr. Selvete Krasniqi Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Merita Berisha Prof. Assoc. Naser Ramadani Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli Prof. Ass. Lul Raka Prof. Ass. Sefedin Muçaj
2	O	Seminar i tezës së doktorates - III	0	15	15	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji Mentori i kandidatit
3	O	Puna hulumtuese e temës (raporti i progresit nga mentori)				24	
		Total				30 ECTS	

	Viti II-të						
Semestri IV-të				Orët/semester			
Nr.	O/Z	Lëndët seminarike	L	S	U	ECTS	Mësimëdhënësi
1	O	Journal club	0	15	15	3	Prof. Dr. Isuf Dedushaj Prof. Dr. Selvete Krasniqi Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Merita Berisha Prof. Assoc. Naser Ramadani Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli Prof. Ass. Lul Raka Prof. Ass. Sefedin Muçaj
2	O	Seminar i tezës së doktorates - IV	0	15	15	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji Mentori i kandidatit
3	O	Puna hulumtuese e temës (raporti i progresit nga mentori)				24	
		Total				30 ECTS	

	Viti III-të						
Semestri V-të				Orët/semester			
Nr.	O/Z	Lëndët seminarike	L	S	U	ECTS	Mësimëdhënësi
1	O	Journal club	0	15	15	3	Prof. Dr. Isuf Dedushaj Prof. Dr. Selvete Krasniqi Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Merita Berisha Prof. Assoc. Naser Ramadani Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli Prof. Ass. Lul Raka Prof. Ass. Sefedin Muçaj
2	O	Seminar i tezës së doktorates - V	0	15	15	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji Mentori i kandidatit
3	O	Prezantimi i rezultateve të temës në konferenca vendore shkencore				6	
4	O	Prezantimi i rezultateve të temës në konferenca ndërkombëtare shkencore				10	
5	O	Përgatitja e temës së doktorates (raporti i progresit nga mentori)				8	
		Total				30 ECTS	

	Viti III-të						
Semestri VI-të				Orët/semester			
Nr.	O/Z	Lëndët seminarike	L	S	U	ECTS	Mësimëdhënësi
1	O	Journal club	0	15	15	3	Prof. Dr. Isuf Dedushaj Prof. Dr. Selvete Krasniqi Prof.Dr. Tahire Gjergji Prof. Dr. Gjyle Mulliqi Prof. Assoc. Merita Berisha Prof. Assoc. Naser Ramadani Prof. Assoc. Isme Humolli Prof. Ass. Ilir Begolli Prof. Ass. Lul Raka Prof. Ass. Sefedin Muçaj
2	O	Seminar i tezës së doktorates - VI	0	15	15	3	Prof.Dr. Tahire Gjergji Mentori i kandidatit
3	O	Publikimi shkencor në revista me recenzion ndërkombëtar				10	
4	O	Mbrojtja publike e temës së doktoratës				14	
		Total				30 ECTS	

Studentët e drejtimeve të caktuara do të kenë mundësi që në semestrin e pare dhe të dytë të përzgjedhin seminare nga moduli i tyre përkatës për të arritur vlerën e 30 ECTS (2 respektivisht 3 lëndë seminarike).Për formimin e një grupi seminarik nevojiten së paku 3 studentë për grup.

Lista e lëndëve zgjedhore të semestrit të I-rë

	Moduli/Course	L	S	E	ECTS	Dept.	Professor
1.1.	Principet dhe metodat e epidemiologjisë	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Dr.Isuf Dedushaj
1.2	Epidemiologjia dhe kontrolla e sëmundjeve ngjitëse	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Assoc.Dr.Isme Humolli
1.3	Epidemiologjia dhe kontrolli i sëmundjeve jongjitëse	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Assoc.Dr.Naser Ramadani
1.4	Vlersimi i riskut mjedisor	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Dr.Tahire Gjergji
1.5	Menaxhimi i situatave emergjente ne fatkeqesite	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Dr.Selvete Krasniqi
1.6	Strategjite shendetesore dhe sistemet shendetesore	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Assoc.Dr.Merita Berisha
1.7	Politikat publike dhe administrimi I shendetit publik oral	15	5	15	3	Shëndet publik, Stomatologjia	Prof.Ass.dr Ilir Begolli Prof.Assoc.dr Fatmir Dragidella Ass.dr.sc.Ferijalle Perjuci
1.8	Kontrolli i infeksioneve	15	5	15	3	Shëndet publik	Prof.Ass.Dr.Lul Raka

Lista e lëndëve zgjedhore të semestrit të II-të

	Moduli/Course	L	S	E	ECTS	Dept.	Professor
2.1	Principet dhe praktikat e diagnostikimit te semundjeve ngjitese		20	20	4	Shëndet publik	Prof.Dr.Gjyle Mulliqi
2.2	Paraqitja dhe riparaqitja e semundjeve infektive		10	20	4	Shëndet publik	Prof.Ass.Dr.Sc.Sefedin Muçaj
2.3	Mbikqyrja dhe raportimi i semundjeve		30	10	4	Shëndet publik	Ass.Dr.Sc.Ariana Kalaveshi
2.4.	Epidemiologjia e semundjeve orale kronike dhe infektive		20	40	4	Shëndet publik, Stomatologjia	Prof.dr Isuf Dedushaj Prof.Ass.dr Ilir Begolli Prof.Ass.dr Milaim Sejdini
2.5	Legjislacioni nderkombetar mjedisor		20	15	4	Shëndet publik	Prof.Dr.Selvete Krasniqi Prof.Dr.Tahire Gjergji
2.6	Siguria e ushqimit		20	20	4	Shëndet publik	Prof.Ass.Dr.Sabit Bajqinovci
2.7	Nutricioni dhe shëndeti publik		20	20	4	Shëndet publik	Prof.Dr. Prof.Dr.Tahire Maloku-Gjergji Prof.Dr.Selvete Krasniqi
2.8	Politika e shendetit oral dhe mplakja		25	15	4	Shëndet publik, Stomatologjia	Prof.Ass.Dr Ilir Begolli Prof.Ass.dr Metush Disha
2.9	Principet e kujdesit shendetesor dhe menaxhmenti		20	20	4	Shëndet publik	Prof.Ass.Dr.Ilir Begolli
2.10	Edukimi shendetesor dhe shkencat e sjelljes		25	15	4	Shëndet publik	Ass.Dr.Sc.Drita Zajmi
2.11	Semundjet profesionale dhe parandalimi i lendimeve		20	20	4	Shëndet publik	Prof.assoc.dr Xhevat Shkodra Prof.assoc.dr Merita Berisha

2.12	Hulumtimi ne komunitet i shendetit publik stomatologjik		20	20	4	Shëndet publik, Stomatologjia	Prof.assoc.dr Merita Berisha Prof.assoc.dr Sami Salihu Ass.dr.sc. Resmije Ademi
2.13	Promovimi i shendetit oral dhe stomatologjia preventive		20	20	4	Shëndet publik, Stomatologjia	Ass.dr.sc. Drita Zajmi Prof.Assoc.Dr Agim Begzati
2.14	Kariesologjia		20	20	4	Stomatologjia	Prof.Assoc.Dr.Agim Begzati

Struktura e studimeve të programit PhD "Shëndetit Publik"

Semestri	Aktiviteti	ECTS
Semestri i I-rë	Studenti përzgjedhë 2 lëndë nga semestri i I-rë. Secila lëndë përmban 5 ECTS	30 ECTS
Semestri i II-të	Studenti përzgjedhë 3 lëndë seminarike nga moduli përkatës. në semestrin e II-të.	30 ECTS
Semestri i III-të	Studenti grumbullon 30 ECTS kredi pas miratimit dhe aprovimit të projekt propozimit të tezës së doktoratës dhe pas nominimi të mentorit nga senati i UP-së	30 ECTS
Semestri i IV-të	Studenti grumbullon 30 ECTS kredi pas publikimit të një pjese të rezultateve të fituara në ndonjë revistë shkencore me recension ndërkombëtar të fushës gjegjëse dhe me impakt faktor (IF)	30 ECTS
Semestri i V-të	Studenti grumbullon 60 ECTS kredi	60 ECTS

Semestri i VI-të	pas mbrojtës me sukses të tezës së doktoratës	
TOTAL		180 ECTS

2.15. Përshkrimi i çdo moduli/lënde:

2.15.1. **Emërtimi:BIOSTATISTIKA ME INFORMATIKË MJEKËSORE**

2.15.1.1. **Përmbajta:**

Biostatistika dhe informatika mjekësore është modul që zgjeron dhe thellon njohuritë e fituara gjatë studimeve bachelor dhe master dhe mundëson zgjedhjen e drejtë të metodave për përpunimin statistikor të të dhënave dhe vërtetimin e hipotezave të hulumtimeve shkencore si dhe aplikimin e programeve të ndryshme softwerike ne përpunimin e te dhënave dhe kalkulimin e parametrave statistikor.

2.15.1.2 Qëllimi dhe rezultatet e pritura:

Objektivi i këtij moduli është njoftimi me llojet e studimeve, prezentimin e të dhënave, definimin e llojeve të variablave statistikore, njehsimin e probabiliteti, Baye's Rule, Incidencës, Prevalencës, Risku Relativ dhe Odds Ratio (OR), intervalet e konfidences (CI 95%), testimin e hipotezës, krahasimin e dy mesatareve, analizën e variancës, testet joparametrike, statistikën inferenciale, tabelat e kontingjences, tabelat Multiple dhe 2 X 2 tabelat, korrelacionin, regresionin linear, regression multipel, regresion logjistik, Analizën e mbijetesës, hyrje në sistemin e informimit shëndetesor, regjistrimin elektronik të pacientit dhe mbrojtja e të dhënave, në bazë të ISO standardeve dhe udhërrëfyesve, faktet kryesore rreth funksionimimt të sistemit SISH.

Pas përfundimit të ketij moduli studentet do te kuptojne dhe jene ne gjendje te aplikojne statistiken descriptive, observuese dhe inferenciale, duke perfshire:

Teknikat ne statistikat numerike deskriptive dhe grafike;
kalkulimet e probabilitetit;
llogaritjen e intervaleve te konfidences;
korrelacionin dhe regresionin linear
testimin e hipotezes, testet parametrike me te shpeshta dhe joparametrike;
teknikat joparametrike dhe tabelat e kontigjences me analiza;
hyrje ne dizajnin hulumtues;
informatat bazike per biasin, validitetin dhe vlefshmerine;
perdorimin e paketeve statistikore per kalkulime (SPSS).

Studentet do te informohen per sistemin e informimit shendetesor, kartelat elektronike te pacienteve dhe mbrojtjen e te dhenave. Ata do te mesojne si t'i shfrytezojne te dhenat, interpretojne faktet kryesore si dhe do te kuptojne si punon sistemi ne pergjithesi.

2.15.1.3 Format e mësimdhënies dhe mësimnxënjës:Mësimi do të jetë i rrregulltë,në formë të ligjeratave, raste studimi, punë individuale dhe grupore dhe prezentime të studentëve. Zbatim i metodës PBL (problem-based learning).

2.15.1. 4 Metodat e vlerësimit: Vijimi i rregullt 10% , Puna grupore dhe prezentimi 30%
Detyrat shtepiake individuale 30%, Testi vleresues 30%, Gjithsejt 100%

2.15.1.5Mjetet e konkretizimit/IT:

LCD Projector, Power Point, Overhead Projector, vet-mësimi (sistemi i e-learning); Ushtrimet praktike në institucionet edukative të përcaktuara nga tema e modulit. Ushtrimet dhe puna vetanake e cila paraqitet në formë të prezantimit..

2.15.1.6 Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Ligjerata	Seminare	Ushtrime	Prezentime	Kontakt me profesorin	Vetstudimi	Ngarkesa e orëve
15	14	15	1	15	55	125

2.15.1.7Literatura:

1. Basic Biostatistics: Statistics for Public Health Practice by B. Burt Gerstman, Jones and Bartlett Publishing
2. Biostatistics: A Foundation for Analysis in the Health Science (9th edition) by Wayne Daniel, John Wiley & Sons.
3. R.H. Riffenburgh: Statistics in Medicine, Academic Press, ISBN O-12-588560-1
4. Coiera, E. Guide to Health Informatics. 2nd ed. New York, NY: Oxford University Press; 2003.
5. Hanson, CW. Healthcare Informatics. New York, NY: McGraw-Hill, Medical Pub. Division; 2006.
6. Medical Informatics: Practical Guide for the Healthcare Professional 2007; By Robert Hoyt, Melanie Sutton Phd, Ann Yoshihashi
7. The Strategic Application of Information Technology in Health Care Organizations (The Jossey-Bass Health Series) by John P. Glaser (Hardcover - Feb 8, 2002)
8. Dictionary of Health Information Technology and Security by David Edward Marcinko and Hope Rachel Hetico (Paperback - April 30, 2007)

Literatura shtesë

Bernard Rosner, Fundamentals of Biostatistics, 2006, Duxbury Press, Belmont, CA.
Jekel, Katz, Elmore.: "Epidemiology, Biostatistics and Preventive Medicine"
Biostatistics for the Health Sciences by R.Clifford Blair and Richard A.Taylor
Monitoring the Health of Populations: Statistical Prnciples and Methods for Public Health Surveillances, edited by R. Brookmeyer and D. Stroup (2004) Oxford University Press
British Journal of Psychiatry. 157:197-207, 1990 Aug.
The European Health Report 2009, Health and health systemsJournal of medical informatics
Zaletel-Kragelj L, Božikov J, eds. Methods and tools in public health. Lage: Hans Jacobs Publishing, 2010.

2.15.2.Emërtimi: METODOLOGJIA E PUNËS KËRKIMORO-SHKENCORE

2.15.2.1Përmbajta:

Ky modul mundëson njohjen dhe përdorimin e matjeve të ndryshme shkencore, përshkrimin dhe interpretimi kritik të rezultateve të fituara, mënyrat e teknikat e prezentimeve si dhe metodologjinë e hulumtimeve shkencore, llojet e punimeve, shfrytëzimin e të dhënave dhe mjekësinë e bazuar në fakte. Aftësinë për të shfrytëzuar faktet (të dhënat) kyçe nga burimet e të dhënave si dhe artikujt shkencor, kërkimi i literaturës, shkruarja e punimeve sipas metodologjisë së hulumtimeve shkencore si dhe leximi kritik i artikujve shkencor.

2.15.2.2Qëllimi dhe rezultatet e pritura:

Ky modul mundëson njohjen e metodave te nevojshme per dizajnimin dhe realizimin e hulumtimeve, rishikimin e metodave kuantitative te zakonshme qe perdoren dhe ndërlidhjen me te dhena, analizimin kritik te literatures, si dhe koncepteve të të mësuarit, metodologjisë së hulumtimit, studimit dhe prezentimit. Realizimin e pavarur te projektit hulumtues

Pas përfundimit të këtij moduli studenti do të aftësohet për:

- llojet e hulumtimeve shkencore në mjekësi

- planifikimin e pavarur të hulumtimit
- përdorimin e bibliotekave elektronike dhe resurseve të tyre,
- përshkrimin dhe interpretimin kritik të rezultateve të fituara,
- zgjedhjen adekuate të mostrës në hulumtim dhe rendesinë e mostres per hulumtimin perkates, testet e përshtatshme statistikore, përshkruarjen e limitimeve eventuale, interpretimin e rezultateve dhe intervaleve të besueshmërisë
- kerkim te literatures shkencore dhe zgjedhjen e artikujve adekuat shkencor
- shkruarjen e punimeve sipas metodologjisë së hulumtimeve shkencore
- përgatitjen e Projekt Propozimit per temen e PhD si dhe aftesohet ne shkruarjen e protokolit te hulumtimit

përgatitjen për komunikimin oral për konferenca dhe takime si dhe poster prezentime

2.15.2.3 Format e mësimdhënies dhe mësimnxënjës:Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjërata grupore, punë seminarike në grupe të vogla, zbatim i metodës PBL (problem-based learning).Studim rasti

2.15.2.4Metodat e vlerësimit: Vijimi i rregullt 10%, Puna grupore dhe prezentimi individual 30%, Detyrat shtepiake individuale 30%, Testi vleresues 30%, Gjithsejt 100%

2.15.2.5 Mjetet e konkretizimit/IT:LCD Projector, Power Point, Overhead Projector, vet-mësimi (sistemi i e-learning); Ushtrimet praktike në institucionet edukative të përcaktuara nga tema e modulit. Ushtrimet dhe puna vetanake e cila paraqitet në formë të prezantimit..

2.15.2.6 Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Ligjerata	Seminare	Ushtrime	Prezentime	Kontakt me profesorin	Vetstudimi	Ngarkesa e orëve
15	14	15	1	15	55	125

2.15.2.7Literatura:

Zaletel-Kragelj L, Božikov J, eds. Methods and tools in public health. Lage: Hans Jacobs Publishing, 2010.

Waravikova&Tulchinsky: The New Public Health, 3rd Edition, 2014

Leed P.D and Ormrod J.E., Practical research: Planning and Design, 7th Edition.2001

Charles H. Hennekens, Julie E. Buring. Epidemiologjia në Mjekësi. Tiranë: Libri Universitar, 1998

Marušić M. i sur. Uvod u znanstveni rad u medicini. 3. izdanje. Zagreb: Medicinska naklada; 2004.

Thomas L. Najmlađa znanost: Bilješke promatrača medicine. Zagreb: Medicinska naklada; 1995.

Writing Human Factors Research Papers, Harris Done, 2011

How towrite scientific paper

Critical Appraisal Skills Programme (CASP) Systematic Review Checklist

http://www.casp-uk.net/#!casp-tools-checklist

Jekel, Katz, Elmore.: "Epidemiology, Biostatistics and Preventive Medicine"

P. Armitage, G, Berry, J.N.S. Matthews. Statistical Methods in Medical Research, 4th Edition 2002

2.15.3.Emërtimi:ETIKA NË HULUMTIMET MJEKESORE

2.15.3.1Përmbajta:

Etika në hulumtimet mjekësore (EHM) është një standard ndërkombëtar etik dhe shkencor I cilësisë në hulumtimet mjekësore, problemet etike, praktika dhe aplikimi i tyre në shëndetësi. Pajtueshmëria me

këtë standard paraqet etikën në nivelin më të larë të parimeve në Deklaratën e Helsinkit si discipline që analizon dhe justifikon sistematikisht dhe në mënyrë racionale zgjedhjet moralo-etike.

2.15.3.2 Qëllimi dhe rezultatet e pritura:

